

LIGJ
Nr. 23/2024

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË FUSHËN E ARSIMIT TË LARTË
DHE KËRKIMIT SHKENCOR

Në mbështetje të neneve 78, 83 e 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 21.3.2024.

Shpallur me dekretin nr. 137, datë 8.4.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Bajram Begaj.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
NË FUSHËN E ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në vijim referuar si "Palët", me besimin se bashkëpunimi dypalësh në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor do të forcojë marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve dhe të interesuar për të zhvilluar bashkëpunimin arsimor dhe shkencor me përfitim reciprok, kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1

Palët do të inkurajojnë dhe mbështesin bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe shkencës. Ato do të sigurojnë shkëmbimin e vazhdueshëm të informacionit mbi organizimin e institucioneve arsimore dhe të kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Palët do të inkurajojnë dhe mbështesin vendosjen e lidhjeve të drejtpërdrejta midis strukturave përkatëse në nivelin e ministrive, të universiteteve si dhe të institucioneve të tjera të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Neni 3

Palët do të inkurajojnë dhe mbështesin një pjesëmarrje të gjerë të mësimeve, ekspertëve dhe kërkuesve shkencorë në seminare, simpoziume dhe konferenca ndërkombëtare të organizuara nga palët dhe do të bashkëpunojnë ngushtë në trajnimin e tyre.

Neni 4

Palët do të mbështesin një bashkëpunim aktiv të institucioneve të tyre në kuadrin e programeve arsimore të Bashkimit Evropian, të Këshillit të Evropës dhe të UNESCO-s.

Neni 5

5.1 Palët do të inkurajojnë dhe mbështesin bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve akademike në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës nëpërmjet projekteve të përbashkëta shkencore dhe hulumtuese.

5.2 Palët do të mbështesin pjesëmarrjen e përbashkët të institucioneve arsimore dhe kërkimit shkencor në projekte të karakterit dypalësh dhe shumëpalësh.

Neni 6

6.1. Palët do të inkurajojnë lëvizshmërinë e studentëve në të dyja vendet. Kandidatët e interesuar aplikojnë brenda njëjësive përgjegjëse të secilit vend. Njësitë përgjegjëse të arsimit të lartë në secilin vend, përcaktojnë kriteret dhe modalitetet për administrimin e aplikimeve dhe përzgjedhjen e tyre.

6.2. Palët do të ofrojnë bursa për studentët sipas legjislacionit në fuqi të secilit vend.

6.3 Shuma totale e bursës për studentët e të dyja Palëve do të jetë 1000 euro për vit akademik për secilin përfitues. Mënyra e shpërndarjes së bursave do të jetë në pajtim me legjislacionin e vendit përkatës.

6.4 Numri maksimal i bursave që do të ofrohen nga secila Palë është 30 (tridhjetë) bursa në vit.

6.5 Palët ngrenë grupe *ad-hoc* për të shqyrtuar kriteret dhe procedurat për alokimin e bursave.

Neni 7

Palët do të shkëmbejnë ekspertë në fushën e akreditimit të arsimit të lartë për shkëmbim përvoja dhe pjesëmarrje në procesin e akreditimit.

Neni 8

Palët do të punojnë së bashku për lehtësimin e procedurave për njohjen reciproke të certifikatave, diplomave, titujve dhe gradave shkencore të lëshuara nga institucionet arsimore të të dyja palëve.

Neni 9

9.1 Për realizimin e kësaj marrëveshjeje, palët do të ngrenë grupet e punës për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, të cilët do të takohen në mënyrë të alternuar në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës.

9.2 Grupet e punës do të jenë të përbërë nga 3–5 veta. Ato do të realizojnë vizita në vendin e palës tjetër për shkëmbim përvoja, për një periudhë të dakordësuar në përputhje me veprimtarinë dhe parashikimet buxhetore përkatëse.

9.3 Secila palë i merr përsipër detyrimet financiare për shpenzimet e delegacionit të vet.

Neni 10

10.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me të cilin Palët njoftojnë njëra-tjetrën, për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të marrëveshjes dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar kohore.

10.2 Çdo mosmarrëveshje në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshje zgjidhet ndërmjet palëve me mirëkuptim, ose nëpërmjet kanaleve diplomatike.

10.3 Kjo marrëveshje mund të ndryshojë me pëlqimin reciprok të Palëve. Ndryshimet hyjnë në fuqi me të njëjtën procedurë si marrëveshja.

10.4 Secila Palë në çdo kohë mund të kërkojë përfundimin e marrëveshjes, duke njoftuar me shkrim Palën tjetër, nëpërmjet kanaleve diplomatike. Përfundimi do të ketë efekt 6 (gjashtë) muaj pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë

Bërë në Tiranë, më 5.7.2023, në dy origjinalë, në gjuhën shqipe.

**Për Këshillin e Ministrave të Republikës
së Shqipërisë**

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

Për Qeverinë e Republikës së Kosovës

MINISTËR I ARSIMIT, SHKENCËS,
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
Arbërije Nagavci